

LIGJ
Nr. 8266, datë 19.12.1997

**PËR NDRYSHIMIN E NENIT 41/A, TË LIGJIT NR. 7596, DATË 31.8.1992, “PËR NJË
SHITESË NË LIGJIN NR. 7491, DATË 29.4.1991, ‘PËR DISPOZITAT KRYESORE
KUSHTETUESE”**

Në mbështetje të nenit 43, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 7596, datë 31.8.1992 “Për një shtesë në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 ‘Për dispozitat kryesore kushtetuese”, neni 1 ndryshohet si vijon:

“Kontrolli i Lartë i Shtetit është organi më i lartë i kontrollit në Republikën e Shqipërisë. Objektivi kryesor i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kontrolli financiar e vlerësues dhe për zbatimin e ligjshmërisë në sektorin publik.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është person juridik publik, i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij, që ka buxhet të veçantë të miratuar nga Kuvendi Popullor.

Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqet raportin vjetor të veprimtarisë së tij në Kuvendin Popullor.

Konfliktet e kompetencave, ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve të tjera shtetërore (publike), gjykohen në shkallë të parë nga Gjykata e Apelit.

Kryetari dhe zëvendëskryetarët zgjidhen me propozim të Presidentit të Republikës nga Kuvendi Popullor me shumicë absolute, për një mandat 7-vjeçar, por jo më shumë se dy herë radhazi. Vetëm për mandatin e parë të zgjedhjes, zëvendëskryetari i parë zgjidhet për një mandat 5-vjeçar dhe zëvendëskryetari i dytë për një mandat 3-vjeçar.

Mandati i drejtuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit përfundon para afatit vetëm për shkak:

- të heqjes dorë nga detyra;
- të dënimit me vendim të formës së prerë për një vepër penale;
- të ngarkimit me një detyrë të papajtueshme;
- të gjendjes shëndetësore që e bën të pamundur përmbushjen e detyrës;
- të vdekjes.

Organizimi dhe funksionimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit përcaktohet me ligj të veçantë.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekreten nr. 1974, datë 22.12.1997, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani